



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Prokuroria Themelore në Prizren / Osnovno Tužilaštvo u Prizren / Basic Prosecution in Prizren

DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA

PP/I nr: 255/15

Prizren 30.06.2017

PROKURORISË THEMELORE PRIZREN

-Departamentit të përgjithshëm-

Bashkangjitur kësaj shkrese ju dërgojmë në kompetencë çështjen penale ndaj të akuzuarve Haziz Tafaj etj. të cilët kanë qenë të kalëzuar penalisht nga "Agrokosova Holding" SHPK-Shirokë - Suharekë, për shkak të dyshimit se kanë kryer vepra penale mashtrimi në detyrë nga neni 246 të KPRK, falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 të KPRK, lidhja e kontratës së dëmshme nga neni 292 të KPRK, keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 të KPRK dhe shpërlarja e parave sipas ligjit nr. 03/L-196.

Kjo çështje penale së pari ka qenë drejtuar në Prokurorinë Speciale e të cilët më pas kompetencën e kanë sjellë në Prokurorinë Themelore në Prizren duke konsideruar se kjo është kompetencë e kësaj Prokurorie nga fakti se nuk ka prova të besueshme që mbështesin dyshimin e arsyeshëm që të pandehurit të kenë kryer veprën penale shpërlarja e parave nga neni 308 të KPRK siç specifikohet në nenin 32 të Ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit apo të krimit të organizuar.

Me të pranuar këtë çështje e në marrëveshje me Kryeprokurorin e kësaj Prokurorie iu është dërguar Drejtorisë Rajonale të Policisë në Prishtinë – Njësitit të hetuesisë për krime ekonomike dhe korrupsion kërkesa për mbledhjen e informacionit me datë 30.09.2015 e më pas e njëjta është përsëritur me 15.11.2016 dhe me 2.02.2017 duke kërkuar përshpejtimin e çështjes.

Me datë 27.04.2017 ka arritur Kallëzimi penal ndaj të dyshuarit Haziz Tafaj për dyshimin e bazuar se ka kryer veprat penale:

PP/I - 255/15 - I

- falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par. 1 të KPK, ✓
- rastet të posaçme të falsifikimit të dokumenteve nga neni 399 të KPK, ✓
- keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi nga neni 290 par. 1.4 dhe 1.5 të KPK, ✓
- lidhja e kontratave të dëmshme nga neni 291 par. 1 të KPK dhe ✓
- mashtrimi nga neni 335 të KPK ✓

Sa i përket personave të tjerë të cilat kanë qenë të kallëzuar si Lulzim Berisha, Burim Kuqi, Shaban Tafaj, Nijazi Devetaku dhe TEB Banka Filiala në Lipjan në bazë të hetimeve të kryera nga ana të Njësitit për krime ekonomike në Prishtinë dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës është konstatuar se nuk është mundur të sigurohen prova të mjaftueshme për të ngritur kallëzimin penal ndaj personave në fjalë për veprat penale të kallëzuara.

Andaj pasi që në këtë drejtim veprat penale për të cilat është kallëzuar këtu i akuzuari Haziz Tafaj me Kallëzim penal janë kompetencë e juaj ua dërgojmë në procedim të mëtejme.

Shtojcë: Kallëzimin penal i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë – DHKEK/DPP Prishtinë me nr. të rastit 2016-KE-159 të datës 25.04.2017.

Bashkangjitur këtij akti i keni 12 folldera në origjinal dhe 13 folldera kopje.

PROKURORI I SHTETIT
Gene Nixha





Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Punëve të Brendshme
 Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
 Ministry of Internal Affairs
 Policia e Kosovës / Policija Kosova / Kosovo Police



Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/
 Generalna Policijska Direkcija / General Police Directorate

MEMORANDUM ZYRTAR - SLUZHBI MEMORANDUM - OFFICIAL MEMORANDUM

PËR: Prokurorinë Themelore - Prizren
ZA: Departamenti për Krime të Rënda
 Prokurorin Genc Nixha

Data: 25.04.2017
Datum:


PËRMES: Nënkolonel Emin Beqiri
PREKO: Drejtor i DHKEK / Divizioni i Hetimeve
 DPP-Prishtinë
 Tog. [Signature]
 Shef i SHF-DHKEK / DPP - Prishtinë
 Rr. [Signature]
 Shef i NJHF-DHKEK / DPP - Prishtinë

Nr. i Referencës: 06/1-02/SHF/ 123-
Br. Referencije: 2017

Nr. i rastit apo shkreses: 2016-KE-159
Br. slucaja ili spisa:

PREJ: [Signature]
OD: Hetues në NJHF - DHKEK / DPP - Prishtinë

LËNDA:
PREDMET: Kallëzim penal



Në bazë të nenit 81 paragrafi 1 dhe 2 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës paraqesë këtë:

KALLËZIM PENAL

Kundër: Haziz Tafaj - i biri i Zeqir Tafaj dhe i nënës Sabrije, i lindur me [Signature] 1967 në fshatin Gelanc - Suharekë, me vendbanim në fsh. Gelanc - Suharekë, me përgatitje shkollore - Shkolla e mesme - Biologji me nr. kontaktues [Signature], me nacionalitet shqiptarë, shtetas i Kosovës i martuar, administrator në „Agrokosova Holding“.

Ne data bazen policore Haziz Tafa është i evidentuar si i dyshuar në keto raste:

Faqe 1 nga 22

Adresa: Rr. Luan Haradinaj pn. 10000 Prishtinë - Kosovë,
 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës,

1. 2011-XI-68 date 06.01.2011 vepra penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar deri,
2. 2014-GB-970 date 05/12/2014 vepra penale Uzurpim i pronës ✓
3. 2015-KE-109 date 21.04.2015 vepra penale Keqpërdorimi i autorizimeve ekonomike, ✓
4. 2015-KE-105 date 16.04.2015 veprat penale Legalizim i përmbytjes së rreme, Mashtrim, Keqpërdorimi i autorizimeve ekonomike ✓

SEPSE

1. Haziz Tafaj ne shtator te vitit 2007 ne Prishtine në cilësinë e Administratorit në Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar, „Agrokosova Holding“ sh.p.k. me nrb.70423906 ka përpiluar dhe përdorur pa autorizim „statutin e shoqerise“ ne te cilin e ka falsifikuar nënshkrimin e aksionarit Gianfranco Fantinel, meqenëse i njëjti nuk ka marr pjesë në përpilimin e statutit dhe nuk e ka nënshkruar këtë statut në emër të kompanisë „Agrokosova Holding“ dhe në bazë te statutit te falsifikuar ka bërë ndryshime në ARBK dhe e ka marr nën menaxhim kompanin e lartcekur, ✓
2. Haziz Tafaj me date 22.03.2010 ne Prishtine me autorizim te falsifikuar kinse eshte perfaqesues i „Agrokosova Holding“ ne emer te saj lidh marrveshje kreditore me Banken Ekonomike në Prishtinë për mbitërheqje për biznes në shumë prej 230,000.00 euro në afat prej 6 (gjashte) muaj, ku huamarrsi është „Agrokosova Holding“ Sh.p.k. „QMI“ sh.p.k. dhe per kete marrveshje e lënë në formë të pengut prap pa autorizim pasurin e palujtëshme „Agrokosova Holding“ parcelat sipas fletës poseduese UL-72116046-01019, gjithësesjt 6.74.41 m.Vlera e Patundëshmëris së lënë peng nga komisioni i Bankës është vlerësuar në 1,348.820.00 € . ✓
3. Haziz Tafaj me date 16.12.2010 ne Suhareke pa autorizim e duhur nga „Agrokosova Holding“ lidh kontratë mbi shitblerjen e inoksit të dëmtuar hekur mbeturinë tërheqje e paisjeve dhe pastrimin e podrumit në vlerë prej 120,000.00 € (njëqind e njezetmij Euro), e lidhur ne mes të : „Agrokosova Holding“ (Shitës) dhe „Biopak“ (Blerës) , ✓
4. Haziz Tafaj me date 10.11.2010 ne Suhareke pa autorizim e duhur nga „Agrokosova Holding“ lidh marrveshje ne emer të „Agrokosova Holding“ i cili ia shet tanqet (rezervuaret) Fadil Demirit nga Mushtishti ne vlerë prej 10,000.00 euro . ✓
5. Haziz Tafaj per vitin 2013 ne Prishtine pa autorizim e duhur duke prezentuar dokumente me te dhena te rrejshme ka aplikuar për subvecone ne emer te „Agrokosova Holding“ duke i mashtruar dhe vene ne lajthim zyrtaret ne Ministrin e Bujqësis , Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe me date 12.11.2013 pranon pagesa direktet me shumë të përgjithëshme prej 62,694.00 € në xhirollogarin bankare kinse te „Agrokosova Holding“ me _____ në TEB bankë me, për vreshta me sipërfaqe prej 313.47 ha. ✓
6. Haziz Tafaj me date 11.12.2013 ne Prishtine duke prezentuar dokumente me te dhena te rrejshme kinse eshte i Autorizuar nga „Agrokosova Holding“ dhe ne emer te „Agrokosova Holding“ ka aplikuar ne ATK-ja per rimbursimi dhe me ante te ketyre dokumenteve me permbajtje te rrejshme ka arrit ti mashtrroj dhe ti ve ne lajthim zyrtaret e ATK-se - Departamentin e Thesarit dhe ne emer te „Agrokosova Holding“ jane ✓

rimbursuar shuma prej 596,624.11 euro ne xhirollogarin kinse te "Agrokosova Holding" me nr. [redacted] ne TEB Bankë. Shuma e aprovuar i referohet Aplikacionit te Rimbursimit me nr.1961881 të datës 11.10.2013. W

Andaj nga veprimet e lartcekura ekziston dyshimi i bazuar mire se Haziz Tafaj ka kryer veprat penale:

1. Falsifikim i dokumenteve nga neni 398 par 1 i KPK-se
2. Rastet e Posacme te Falsifikimit te Dokumenteve nga neni 399 par 1, 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5
3. Keqperdorimi i Autorizimve në Ekonomi nga neni 290 paragrafi 1.4,1.5 i KPK-së
4. Lidhja e kontratave te Dëmshme nga neni 291 par 1 i KPRK-së
5. Mashtrim nga neni 335 i KPRK-së.

ARSYETIM:

Në Drejtorin për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Prishtinë kemi pranuar një kërkesë nga Kompania „ Agrokosova Hollding “ për hetimin e këtij rasti lidhur me pretendimet se janë paraqitur indikator te aktiviteteve të „ Mashtrimit për përfitim të paligjshëm“, „ Falsifikim të dokumentacionit me qellim kryerjen e mashtrimeve“, „Falsifikim të pasqyrave financiare“, „Lidhja e kontratave te dëmshme“, „Shpëlarje të parave“, Falsifikim të pasqyrave dhe raporteve financiare“, „Veprime te korrupsionit nga ana e personelit te institucioneve te Kosovës“. Në kërkesë janë bashkangjitur disa dokumente me qellimqe te vërtetojnë këto dyshime.

Provë:Ankesa e dorëzuar ne DHKEK se bashku me dokumentacionin përcjellës

Veprimet e ndërmarrura

Pas marrjes se kësaj informate ne kemi ndërmarr veprime hetimore lidhur me rastin ne fjalë me ç'rast është grumbulluar dokumentacioni relevant lidhur me rastin dhe po ashtu janë intervistuar persona ne cilësinë e dëshmitareve që kanë pasur njohuri lidhur me të njëjtin rast.

Me date 30.09.2015 është pranuar kërkesa për mbledhjen e informatave nga Prokuroria Themelore ne Prizren .

Provë:Kerkesa per mbledhjen e informatave e datës 30.09.2015 me nr.PP.nr.255/15 e lëshuar nga P.Th.Prizren

Në bazë te kërkesës per mbledhjen e informatave me daten 27.10.2015 është intervistuar në cilësi të dëshmitarit Sami Ademi -Menagjer i ndërmarrjes ne „ Agro Kosova Hollding “ i njëjti ne deklaratën e tij me shkrim deklaroi se duke u bazuar ne statutin e falsifikuar te kompanisë te cilin sipas tij e ka falsifikuar i dyshuari Aziz Tafaj ka hapur një llogari bankare ne TEB banke ku të gjitha punët , veprimet afariste , ribursimet e TVSH-së nga ATK-ja , Inkasimi për Autostradën shpronësimin e tokës se Agro Kosovës i ka kryer në këtë llogari që është hapur ne menyrt te kunderligjeshme në emër te kompanisë „ Agrokosova Hollding“ ku sipas ankuesit-dëshmitarit që nga periudha 2008 e deri ne vitin 2014 „Agro Kosova Hollding “ e ka te hapur vetëm një llogari bankare ne Raiffesen Bankë dhe të gjitha aktivitetet - transaksionet afariste të lartcekura shkojnë në llogarinë në TEB Bankë e jo ne llogarinë e „ Agrokosoves“ ne Raiffesen Bankë .Gjithashtu dëshmitari ka deklaruar se Haziz Tafaj ne emër te Agrokosovës Hollding ka lidhur dy kontrata për shitblerjen e inoksit të dëmtuar dhe shiteblerjen e pasterizatorwve gyp në gyp e qe ne dokumtacionin e ARBK-se ky person nuk figuron si përfaqësues apo ne ndonjë pozitë tjetër .Dëshmitari deklaratës se tij ja ka bashkëngjitur edhe kontratat e lartcekura.

Provë: Deklarata e dëshmitarit Sami Ademi .

Kontratë mbi shitblerjen e inoksit të dëmtuar hekur mbeturine tërheqjen e pajisjeve dhe pastrimi i Bodrumit .

Kontratë mbi shitblerjen e pasterizatorit gyp në gyp.

Me date 11.11.2015 është bërë kërkesë Drejtorisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar ne Fushën e Zbatimit të ligjit me nr. Ref .06/1-02/SHF/407-2015 , ku kemi kërkuar informata nga autoritetet Italiane ne lidhje me dy persona Ivonis (Gjyzepe) Dojmo përfaqësues legal ne llogarinë bankare te subjektit QMI-së dhe Roberto (Mendez) Miggoto që është aksionar i QMI-së te cilët dyshohen për mashtrim dhe përfitime të paligjshme, falsifikim te dokumentacioneve me qëllim për kryerjen e mashtrimeve , lidhja e kontratave te dëmshme .Ne kemi kërkuar nga autoritetet Italiane se personat e lartshënuar a kanë apo kanë pas te regjistruar ndonjë biznes . A kanë pasuri te luajtshme dhe te pa luajtshëm ne Itali gjithashtu te dhënat e tyre kriminale .

Me date 11.12.2015 kemi pranuar përgjigje nga ILECO për personat Ivonis Dojmo dhe Roberto Miggoto . Sipas autoriteteve te Italisë Ivonis Dojmo ka dy vepra penale : Mashtrim dhe shkelje te aktit ne lidhje me industrinë .Ivonis Dojmo ka biznese te regjistruar ne Itali .Ndërsa Roberto Migotto sipas autoriteteve Italiane ka dy vepra penale lëndime te paqëllimshme dhe shkelje te aktit për ndërtim. Roberto ka te hapur një biznes te regjistruar ne Itali .

Provë: Kërkesa drejtuar ILECO-s

Përgjigja e pranuar nga ILECO

Me datë 11.11.2015 kemi bërë kërkesë ne Ministrinë e Bujqësisë , Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me nr. Ref .06/1-02/SHF/410-2015 ku kemi kërkuar informata zyrtare ne lidhje me kompaninë „ Agrokosova Hollding “ sh.p.k dhe për „ QMI “ . Të na ofrohen te dhënat për vitin 2012,2013 dhe 2014 , grandet dhe subvencionet nga MBPZHR ne cilën llogari bankare jan derdhur , sa është shuma që janë derdhë dhe në emër të cilës kompani të cekura me lart janë derdhur mjetet.

Grandet dhe subvencionet te cilat janë ne emër te personave te tretë për dhënien e tokave ne shfrytëzim të cilat janë te inkasuar në llogari të personave të tjerë në emër të cilës kompani të cekura më lart janë dhënë këto toka për shfrytëzim.

Me date 17.11.2015 kemi pranuar përgjigjeje nga MBPZHR te cilët na kanë ofruar edhe dokumentacionin lidhur me dy kompanitë e cekura me larte ku sipas kësaj përgjigjeje ne vitin 2013 Kompania „ Agrokosova Hollding “ sh.p.k. ka aplikuar per subvencionim për vreshta tek Divizioni i pagesave direkte ne AZHB me sipërfaqe 313.47 Ha , në emër të Haziz Tafaj i cili në dokumentet e kërkuara nga MBPZHR ka prezentuar edhe Qertifikaten e biznesit me numer 70423906 të kompanis Agrokosova Hollding , kompania është subvencionuar për Vreshta që ka aplikuar .

Në vitin 2014 për subveconimin për vreshta kan aplikuar 5 fermer që kan kontrata me kompanin „ Agrokosova Hollding “ sh.p.k nënshkrues i të cilave është Haziz Tafaj dhe pesë fermerët jan përfitues të subveconeve dhe ju është paguar kesti i pare nga AZHB , ndërsa kesti i dyte është ndalur për të mos u paguar deri ne sqarimin i kësaj shtuate te krijuar.

Me date 21.11.2014 AZHB(Agjencia për Zhvillimin e Bujqesis)-MBPZHR ka bërë kërkesë për hetim të rastit në krime ekonomike në Prokurorin Themelore në Prizren , për aplikuesit njëherit përfituesit e kështit të pare , pasi që jan njoftuar nga Kompania Agrokosova Hollding me drejtor Gianfranco Fantineli lidhur me dyshimin se aplikuesi për subvencionimin për Vreshta tek Divizioni i Pagesave Direkte Haziz Tafaj pa autorizim ka nënshkruar kontratat me pesë fermer (Izeir Krasniqi, Lirim Zefi , Ymer Tafaj , Shqipran Xhemajli dhe Sali Elshani) në emër të Kompanisë Agrokosova Hollding dhe me Autorizim nga Notere- Vizhdane Kuqi .

Me date 05.06.2015 nga Prokuroria Themelore Prizren, Prokurori me Aktvendim i Pushon procedurat hetimore ndaj te pandehurit Izeir (Durmish) Krasniqi me dyshim te arsyeshem se ka bashkryer vepren penale - Nxitja ne lidhjen e kontratës së dëmshme nga neni 291 paragrafi 1 e lidhur me nenet 31 dhe 32 te KP, sepse nuk ekziston dyshim i arsyeshem se kan kryer vepren e till penale Me aktevendimin e këtij organi HP.nr.105/15 të dates 19.05.2015 jane zgjeruar hetimet edhe ndaj te pandehurve: Shaban e Ymer Tafaj , Izeir Krasniqi , Lirim Zefi , Shqipron Xhemalji , Fadil Demiri dhe Sali Elshani me dyshimin te arsyeshem se kan bashkryer ne nxitjen e vepres penale lidhje e kontartës së dëmshme nga neni 291 paragrafi 1 e lidhur me nenet 31 dhe 32 te KP.

→ Me date 08.07.2015 nga Prokuroria Themelore Prizren, Prokurori me Aktvendim i Pushon procedurat hetimore ndaj te pandehurit Haziz Tafaj per shkak te dyshimit te arsyeshem se ka kryer vperen penale Keqpërdorim i autorizimeve ekonomike nga neni 290 paragrafi 1 dhe 1.5 te KP dhe ndaj te pandehurve Shaban e Ymer Tafaj , Izeir Krasniqi , Lirim Zefi , Shqipron Xhemalji , Fadil Demiri dhe Sali Elshani me dyshimin te arsyeshem se kan bashkryer ne nxitjen e vepres penale lidhje e kontartes se dëmshme nga neni 291 paragrafi 1 e lidhur me nenet 31 dhe 32 te KP.

Prokurori me Aktvendim i pushon procedurat hetimore sepse nuk ekziston dyshim i arsyeshem se kan kryer vepren e till penale.

Provë: Kërkesa për marrjen e informatave nga MBPZHR.

Përgjigjeja nga MBPZHR.

Aktvendimet per fillim te hetimeve dhe per pushim te hetimeve nga P.Th.Prizren

Me date 18.11.2015 kemi bërë kërkesë Administratës Tatimore të Kosovës me nr. Ref .06/1-02/SHF/409-2015 ku kemi kërkuar informata zyrtare në lidhje me kompaninë „ Agrokosova Holding “ sh.p.k dhe për „ QMI “ të na ofrohen të dhënat për vitin 2013 , ribursimi ne emër të ATK-së në cilën xhirollogari bankare janë derdhë mjetet , sa është shuma dhe në emër të cilës kompani të cekura më lart janë derdhur mjetet ,qfarë dokumentacioni duhet të dorëzoj një subjekt në ATK-në për ribursim gjithashtu nga ATK-ja kemi kërkuar te gjithë dokumentacionet ne dosjet e tyre prej aplikimit te ribursimit dhe dokumente tjera qe kan për subjektet te cekura me lartë. Pas pranimit te pergjigjes nga ATK-ja në të cilën pergjigje ceket se me daten 11.10.2013 Aziz Tafaj ka bërë kërkesë për ribursim në emër të „Agrokosova Holding “ , shuma e kërkuar për ribursim është 740,114.36 Euro në Xhirollogarin : [redacted] ne TEB Bankë e cila llogari i takon QMI-së.

Me datë 12.02.2014 i Aprovohet ribursimi dhe i është dhënë urdhërpages zyrtare për Departamentin e Thesarit për kërkuesin „ Agrokosova Holding “ pronar Aziz Tafaj ku shuma prej 596,624.11 euro te ribursohen ne xhirollogarin me nr. [redacted] ne TEB Bankë. Shuma e aprovar I referohet Aplikacionit te Ribursimit me nr.1961881 të dates 11.10.2013. Me date 07.07.2015 Haziz Tafaj ka bere kërkesë për ribursim ne emer te „Agrokosova Holding “ , shuma e kërkuar per ribursim është 100,000.00 Euro ne Xhirollogarin : [redacted] ne Raiffeisen Bankë dhe me daten 22.07.2015 nga ATK-ja ju ishte këthyer pergjigjeja per refuzimin e kërkesës për ribursim.

Prova : Kërkesa për marrjen e informatave drejtuar ATK-së kerkesa e datës 18.12.2015.

Prova : Përgjigjja - materiali i pranuar nga ATK-ja .

Me date 01.12.2015 kemi bërë kërkesë ne TEB Banke me nr. Ref .06/1-02/SHF/426-2015 ,ku kemi kërkuar informata zyrtare ne lidhje me xhirollogarinë bankare me nr [redacted] nga kush është hapur , cilët janë personat e autorizuar ne këtë llogari ,qfar dokumentacioni jan dorëzuar për hapjen e kësaj llogarie ,cilat procedurat kan qënë për hapjen e llogaris bankare te biznesit ?

Me date 18.12.2015 kemi pranuar pergjigjejen nga TEB Banka ne te cilen pergjigje vertetohet se me daten 02.02.2009 ne TEB banke është hapur një llogari rrjedhëse e kompanise QMI me nr :20-26-0000084644-80 , ne aplikacionin e hapjes se llogaris e kan nënshkruar Ivonios Doimo dhe Haziz Tafaj ,ndërsa llogaria e dyte me date 18.03.2009 është hapur llogaria bankare ne TEB banke në emër të QMI-së me nr [redacted]

Prova : Kërkesa për TEB banken e datës 01.12.2015 .

Prova : Përgjigjja nga TEB banka .

Me date 10.12.2015 është intervistuar ne cilësi te dëshmitarit Ymredin Osmani - Zyrtar i ATK-së i njëjti deklaroi se e ka bërë kontrollin e subjektit „ Agrokosova Holding” se bashku me koleget e tij te cilët ndryshojnë sipas nevojës , ku janë kontrolluar dokumentacioni i ofruar nga biznesi. Kërkesa për rimbursim nga „ Agrokosova Holding është bërë me date 11.10.2013 , ndërsa zyrtarisht kontrolli nga ATK-ja sipas tij kishte filluar me daten 16.10.2013 .Në emër te biznesit „Agrokosoves Holding” me zyrtaret e ATK-së kishte kontaktuar kontabilisti Burim Kuqi dhe kordinatori Shaban Tafaj. Edhe zyrtarve te ATK-së per rimbursim u ishte dorëzuar llogaria bankare me nr [redacted] në TEB -banke . Nga ATK-ja sipas dëshmitarit ishte bërë kërkesë për informata në të gjitha bankat të cilat operojnë në Kosove dhe ekskluzivisht për këtë xhirollogari të ofruar nga biznesi në bankën TEB , pergjigjeja e bankës ka qenë se „Agrokosova Holding “nuk posedon llogari ne Bakën TEB por numri i llogaris [redacted] është ne emër te QMI-së. I njëjti ka deklaruar se dokumenatcionin qe e ka sjell pala është e nënshkruar nga palet antar te bordit dhe aksionaret gjate mbledhjes se mbajtur me daten 27.09.2013 dhe vendimin e gjykates se qarkut Prizren nr IIC.nr 429/09 te dates 11.06.2012 ku përqindja e aksionarve eshte Grrupo Finikolo Fanitel SPA te kete 18.75% ndersa aksionari QMI shpk te ket 81.25% te aksioneve dhe duke pasur parasysh se rimbursimin e ka kërkuar biznesi si person Juridik e jo aksionaret.

Prova : Deklarata E dëshmitarit Ymredin Osmani të datës 10.12.2015.

Prova : Kërkesat për rimbursim - Dosja 1 dhe 2 si dhe dosjet e biznesit „ Agrokosova Holding “ dosjet: 1,2 dhe 3 .

Me date 14.01.2016 është bërë kërkesë Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës me nr. Ref .06/1-02/SHF/025-2016 , ku është kërkuar që të sigurohet aktvendimi mbi fillimin e hetimeve si dhe aktvendimi mbi pushimin e hetimeve të një pjese të lëndës që ka të bëjë me të dyshuarin Aziz Tafaj i cili është dyshuar për veprën penale : Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi , lidhja e kontratës së dëmshme dhe Veprimtaria e pandërgjegjshme në e ekonomi . Më këtë rast është marr Prokuroria Themelore në Prizren por në një periudhë të më hershme ku nga Prokurori i rastit Ervehe Gashi jemi njoftuar se njëjta lëndë me kërkesë të PSRK-së është transferuar me datë 15.11.2012

Nga Prokuroria Speciale e Kosovës, kemi pranuar shënimin zyrtar në lidhje për të dyshuarin Aziz Tafaj qe ka te bej me dyshimin per kryerjen e veprave penale të cekura më lartë ku sipas shkresave te PSRK-së hetimet kan pushuar në lidhje më këtë rast pasi qe ka kaluar afati kohor i paraparë në nenin 159 par .2 të KPK -së .

Me datë 18.01.2016 është bërë kërkesa për ARBK me nr. Ref .06/1-02/SHF/028-2016 ku janë kërkuar të dhënat lidhur me biznesin, Agrokosova Hallding “ prej themelimit e deri më tani .

Me date 25.01.2016 kemi pranuar përgjigjeje nga ARBK-ja ku figuron se Biznesi „ Agrokosova Hallding “ Sh.p.k. me nrb: 70424906 , me datë 18.04.2007 është regjistruar për herë të par me pronar „ QMI” me nrb: 70032555 si dhe „ Gruppo Niricolo Fantinel SPA “ me nrb: PN-53284 . Haziz Tafaj ne cilësi te perfaqesuesit te njerit aksionar nga viti 2007 e deri ne vitin 2014 bene ndryshime ne

• Pozitën e tij te punës duke filluar sipas statutit si administratorë , her si drejtor , her si antar bordi dhe i cili bazohet ne ndryshimet ne Statut dhe Aneks Statutin e Biznesit .

• Provë: Kërkesa për marrjen e informative ne ARBK-në të dates 18.01.2016

Përgjigjeja nga ARBK-ja të dates 25.01.2016

Me datë 24.02.2016 është bere kërkesë Agjencisë Kosovare të Privatizimit me nr. Ref .06/1-02/SHF/070-2016 ku janë kërkuar te dhënat lidhura me biznesin „ Agrokosova Holding “ dosja me te gjithë dokumentacionin prej aplikimit te privatizim e deri me tani dhe raportet e kontrollit .

Me date 10.03.2016 është pranuar përgjigjeja nga AKP-ja ku pas analizimit te ketij materiali eshte vertetuar se kompania „ Agrokosova Holding “ është privatizuar ne valën e 19 të privatizimit .Sipas Marrëveshjes së zotimeve tek pika 2 tek zotimet për investime kapitale , blerësi zotohet se ndërmarrja do të investoj minimum 8,600.000.00euro në investime kapitale brenda periudhes dy vjeqare ,ndërsa sipas pikes 3 zotimi për punsim , blerësi zotohet se gjate vitit te pare te punësoj minimumin 172 puntor per 6 muajt e parë , kështu që duhet të vazhdoj punsimi i puntoreve mbrenda një viti , ndërsa në vitin e dytë të punsoj 345 puntorë dhe kështu të vazhdohet deri në fund të periudhes të zotimit . Sipas kontrates në raste të mospërmbushjes së investimeve kapitale , blerësi është i obliguar që të paguaj 20% të mungesës së investimeve të zotuara dhe interesi prej 1% në muaj kurse në rastë të mospërmbushjes së zotimeve për punsim , blerësi është i obliguar që të paguaj shumën prej 3,000 euro ne vit.

Pas skadimit te afatit të përmbushje së kushteve të zotimeve AKP ka angazhuar kompanin audituese NSH „ Audit AK “ për të realizuar auditimin në këtë ndërmarrje .

Sipas raportit te fundit te realizuar ne fillim te viti 2015 nga kompania audituese NSH „ Audit AK “ per periudhen e auditimit 27 gushte 2007 -31 dhjetor 2014 , realizimi i punsimit për dy vitet e para eshte 81% dhe 65% , ndërsa punësimi i pranuar sipas raportit të uditorit për gjithë periudhen 21.14%.

Pas përfundimit të raportit të auditimit blerësi ka bërë kërkesë për zgjatjen e afatit të zotimeve dhe ka raportuar investime kapitale ne vlerë prej 1,805,500.00 të cilat investime per at periudh kohore kanë qenë ende te pa audituara .

Prova : Kërkesa për AKP-në të datës 24.02.2016.

Prova : Përgjigjeje nga AKP-ja të datës 10.03.2016.

Me datë 18.04.2016 nga Prokuroria Themelore ne Prizren kemi pranuar kërkesën për mbledhjen e të dhënave .

Masat e ndërmarra bazur në kërkesën për mbledhjen e të dhënave me nr; PP.nr.255/15.

Me date 06.05.2016 është intervistuar në cilësi te dëshmitarit Habib Usaj - punëtorë i administratës ne biznesin „ Agrokosova Holding “ i njëjti deklaroi se ne vitin 2007 kishte filluar te punoj si Drejtor menaxherial ne kompaninë Agrokosova i cili ka ushtruar këtë detyrë deri ne muajin prill të vitit 2008. Ne lidhje me ndryshimin e statutit te kompanisë i njëjti ka deklaruar se janë ndryshuar disa nga pikat e këtij statuti por qe nuk eshte i sigurt se cilat pika duke u arsyetuar se dokumentacioni gjithherë ka qen tek Aziz Tafaj qe ne atë kohë ka qen si administrator i ndërmarrjes dhe njëkohësisht ka qenë anëtar i bordit te drejtorëve i cili bord nuk është kostituara asnjëherë por ndryshimet e pikave te statutit qe janë bere sipas tij i din me mir Gaifranko Fantinelli. Me urdhër te aksionarit shumicë GVF Habib Usaj kishte aplikuar në MTI për ndryshimin e informatave te biznesit ku sipas statutit te këtij biznesit i cili ka ushtruar detyrën e drejtorit te përgjithshëm ne Agrokosova Holding pas këtij aplikimi Aziz Tafaj nuk ka qen i kënaqur me shkarkimin e tij dhe menjëherë e kishte

akuzuar ne polici për këtë aplikim por edhe pas kësaj sipas tij i dyshuari Aziz Tafaj pasi nuk ka arrit qëllimin e tij atëherë ai i ka ofruar bashkëpunim te veçantë me qëllim që ti ndihmoj atij që ta largojmë Fantinellin nga Kosova sepse sipas Azizit ai nuk vjen më në Kosovë dhe i tere biznesi ju mbetet ketyre por i njeti nuk ka pranuar asnjë lloj bashkëpunimi duke e par se te gjitha veprimet qe është dashtë te merren ne bashkëpunim me Azizin do te ishin antiligjore dhe ne fund Aziz Tafaj me 17.04.2008 me një vendim te përbashkët i largon nga puna Habib Usaj dhe drejtorin teknik Giancarlo Koliotassis të cilët kanë qen ne Itali ne atë kohë dhe i njëjti Aziz Tafaj i ka dërguar ftesë që të marr pjesë në mbledhjet e bordit te drejtove ne Agrokosova Holding në vitet 2009-2010 ndërsa ai është dashtë te anuloi vendimin mbi largimin nga puna te nxjerr vendim te ri për punësim pastaj te bej ftes për një mbledhje te tillë .

Prova : Deklarata e dëshmitarit të datës 06.05.2016, shkresa te pranuar nga dëshmitari, Vlerësimi i situatës ne ndërmarrjen Neë co „ Veraria Suhareka “ Sh.p.k. te datës 08.04.2008 , Ftesat për marrjen pjesë ne mbledhjen e bordit nga Haziz Tafes për Habib Usaj , Historiati i biznesit „ Agrokosova Holding “ nga ARBK-ja i datës 14.02.2008, Aneks Statutin i „Agrokosovë “ i datës 12.02.2008, Vendimin e Suspendimit nga Puna nga Haziz Tafaj për Habib Usaj , Certifikatën e vreshtarit, Pasqyrat e investimeve për periudhën tetor 2014 deri ne shkurte 2016, Dokumentet e DUD për „ Agrokosoven“.

Me date 11.05.2016 është intervistuar ne cilësi te dëshmitarit Gianfranco Fantinel -Bashkë aksionar ne „ Agro Kosova Holding “ i njëjti ne deklaratën e tij me shkrim deklaroi se statuti i formuar nga AKM-ja i cili ka përfaqësuar grupin GVF me 55% te aksioneve dhe administratori tjetër i kësaj shoqërie aksionare Aziz Tafaj ,kanë qenë drejtorët teknik Habib Usaj dhe Giancarlo Koliotassis ndërsa Njazi Deveta ku ka qenë person si agjent i regjistruar dhe kjo gjendje ka vazhduar deri me 17.04.2008. Ne fillim kur është privatizuar këtë kompani GVF me 55% , ndërsa 45% kishte QMI-ja por nga këto 45% te QMI-së realisht ishin pjesëmarrës me nga 15% dy kompani si LDR dhe Sartorello Renato dhe QMI 15% me këtë marrëveshje jan nisur nga Italia ,kur janë shpallur fitues është regjistruar vetëm me 45% e jo nga 15% për çdo kompani pagesat janë bërë nga këta zotëri dhe për të cilat ekziston dokumentacioni. Ne tetor te vitit 2009 është bërë kontrata për shitblerjen e aksioneve nga grupi DOIMO -QMI tek GVF dhe nga kjo kohë janë ber 70% te aksioneve ndërsa QMI ka mbetur me 30% dhe ne mbledhjen e 2010 është vendosur ndryshimi i statutit. Më datën 20 qershor te vitit 2010 është bërë ndryshimi zyrtar i statutit dhe është aprovuar statuti ,pastaj ky statut ishte i vlefshëm deri me datën 12.05.2014 kur është aprovuar prapë një statut i ri dhe kuotat apo përqindjet e aksionarëve mbesin 70 % me 30% . I njëjti ka deklaruar se Aziz Tafaj ka ber padi ne Gjykatën Ekonomike ne Prishtinës për ndryshimin e përqindjes se aksioneve dhe me datën 11.06.2012 Gjykata vendos ne favor te Aziz Tafes me 81% për QMI-në ndërsa 18.75% GVF. Ky vendim është anuluar me një aktvendim te Gjykatës së Apelit te datës 18.02.2014 dhe gjendja kthehet ne gjendjen e mëhershme

Ndërsa ne bazë te një vendimi të Gjykatës sipas deklaruesit si masë sigurie dhe qasjen në qeverisje Haziz Tafaj ka hyr me një akt ekzekutiv te cilin e ka keqpërdorur dhe ka fut persona te pa autorizuar dhe persona me të kaluar kriminale dhe punëtorët e Giafranco Fantinellit nuk kanë mundur te rezistojnë dhe njëjti ka marr vendim që të tërhiqen punëtorët që të mos vjen deri te ndonjë problem tjetër dhe për këtë edhe të gjithë punëtorët e tij me vet dëshirë e kanë kërkuar kërkesën nga drejtori gjeneral Giafranco Fantinelli për tu larguar nga puna përkohësisht deri ne zgjidhjen e problemit , përveç kësaj i njëjti ka marr edhe dy vendime përmbajtja e te cilave është për shkak te kësaj gjendje te krijuar nuk ka mundur ta ushtroj detyrën e drejtorit te përgjithshëm dhe kryetarit te asamblesë se aksionarëve dhe nuk ka mundur te marrim asnjë përgjegjësi për dëmet që mund ti shkaktohen

kompanisë nga aksionari QMI sepse nuk kishin qasje ne ndërmarrje as fizike e as ne ndonjë mënyrë tjetër për ti ushtruar detyrat dhe i njëjti vendim ishte edhe për zv. drejtorin Sami Ademi.

Sipas deklaruesit në emër te Agrokosova Hollding janë marr subvencione nga MBPZHR si dhe ribursime nga ATK-ja_këto mjete nuk janë investuar në kompani dhe të gjitha këto mjete janë keqpërdorur nga personi Aziz Tafaj dhe nëse shikohen të gjitha rastet kur ka pas të marr apo te pranoj mjete si për ribursime i ka pranuar ne llogari te QMI-së ndërsa të gjitha detyrimet apo borxhet i adreson ne llogari të AgroKosovës. Në disa raste kur Agrokosova obligohet si ne rastin e marrëveshjes kreditore me bankën ekonomike, ndërsa raste te reja si ndaj kompanisë Gortani dhe inkasimi i TVSH ,gjithashtu për te gjitha obligimet komunale ngarkohet Agrokosova.

Deshmitari deklaroi se statuti është i falsifikuar edhe oer faktin sepse nuk është mbajtur asnjë mbledhje ne lidhje me atë statut.

Prova : Deklarata e dëshmitarit të dt 11.05.2016, Raporti i Auditimit i AKP-së dt 31.12.2014, Njoftimi i punëtorëve për pushim nga puna dt. 24.02.2016,Njoftimi nga Habib Usaj për Doganat e Kosovës , dt.23.02.2016,Vendimi i përkohshëm i Drejtorit Gjeneral , Gianfranco Fantinel , 25 02.2016, Aktvendimi i Gjykatës së Apelit Ae.nr.391/2012 , Propozimi për fillimin e hetimeve kundër përmbaruesit Enis Hoxha dt. 28.03.2016, Statuti i ndërmarrjes -2010,Statuti i themelimit / i parë 2007, Raporti i ATK-së.

Me datë 18.05.2016 është bërë kërkesë Bankës Ekonomike me nr. Ref .06/1-02/SHF/220-2016 ku është kërkuar që të na ofrohen te dhënat lidhur me biznesin „ Agrokosova Hollding si dhe për personin fizik Haziz Tafaj ne lidhje me OVD (Mbitërheqje) me nr.429/Pr te datës 22.03.2010 , si dhe a janë përmbushur obligimet ndaj Bankës Ekonomike nga Shfrytëzuesi i kësaj mbitërheqje.

Prova : kërkesa për Bankën Ekonomike e datës 18.05.2016

Me datë 23.05.2016 kemi pranuar përgjigjeje nga Banka Ekonomike sh.a Prishtinë , ne te cilen përgjigje ceket se me datë 22.03.2010 Haziz Tafaj ka lidh marveshje kreditore me Banken Ekonomike ne Prishtinë për mbitërheqje për biznes në shumë prej 230,000.00 euro ne afat prej 6 (gjashte) muaj , ku huamarrsi është „Agrokosova Hollding “ Sh.p.k. „ QMI” sh.p.k. të cilën e përfaqëson Haziz Tafaj me nr id. ██████████. Haziz Tafaj me një autorizim të datës 22.03.2010 e autorizon veten për lejimin e mbiterheqjes ne Banken Ekonomike në Prishtinë . Ne vitin 2011 Banka Ekonomike në Prishtinë bënë propozim në Gjykatën Komunale në Suharekë për sekuestrimin e objektit të pengut (kolateralit) debitorit „Agrokosova Hollding “ Sh.p.k. e privatizuar nga QMI-ja me pronar Haziz Tafaj ne cilësin e huamarrsit dhe penglënësit .

Sipas përgjigjes nga Banka Ekonomike shfrytëzuesi i mbitërheqjes është kompania „Agrokosova Hollding “ Sh.p.k. „ QMI” sh.p.k.. dhe e njëjta nuk i ka shlyer obligimet që ka ndaj Bankës andaj si prove i bashkëngjitet procedurat kontestimore -civile e zhvilluar pranë Gjykatës Ekonomike në Prishtinë , përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Ekonomike , ku ky aktgjykim është formës së prerë , sipas Aktgjykimit të Gjykatës Supreme me revizionin e paraqitur nga Banka me të cilën e ka obliguar të paditurin „ QMI” Sh.p.k. të përmbush detyrimin që ka nga kontrata për mbitërheqje -OVD.

Provë : Marrëveshjen kreditore për mbitërheqje për biznes Nr.429/Pr , të dt.22.03.2010 , Marrëveshje mbi pengun Nr.429/Pr , të dt.22.03.2010 , Lista e mjeteve te lënë peng Anex -1 të dt.19.03.2010, Autorizim për-debitimin të llogarisë bankare të dt.22.03.2010, Certifikata e regjistrimit të biznesit ,Vërtetimi i regjistrimit të pengut pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Propozimi i Bankes Ekonomike në Prishtinë për Gjykatën Komunale në Suharekë.

Me datë 23.05.2016 është bërë kërkesë Agjencisë Kosovare e Privatizimit me nr. Ref .06/1-02/SHF/228-2016 ku janë kërkuar të dhënat lidhura me biznesin „ Agrokosova Hallding “ në q'farë mënyre - procedure është privatizuar kompania „NSH Suhareka “ tani „ Agrokosova Hollding “, a është liruar kjo kompani nga monitorimi i AKP-së, a janë përmbushur zotimet nga kompania ndaj AKP-së, a kanë të drejt kompania që privatizohet me Spinof Specila pa u liruar nga AKP-ja të bëjë shitjen , tjetërsimin , lënjën kolateral të pronave të kompanisë së privatizuar , cila është baza ligjore që e ndalon një gjë të tillë , dhe të na sigurohet një kopje e kontratës me rastin e privatizimit të kompanisë në fjalë .

Prova : Kërkesa për AKP-së e datës 23.05.2016.

Me datë 23.05.2016 është pranuar përgjigjeje nga AKP-ja dhe NSH „ NBI Suhareka / Agrokosova Hollding “ është privatizuar nga blerësit „ Gruppo Vinicolo Fantinel “ dhe „QMI “ përmes metodës spin off-it Special në valën e 19 -të të shitjes ndërsa periudha e përmbushjes së zotimeve ka qenë 27 gushtë të vitit 2007 deri 31 gusht 2014 , pas kërkesës së aksionarit kryesor vendosi që të vazhdohet afati për përmbushjen e kushteve të marrëveshjes deri me 31.12.2014 dhe pas përfundimit të kësaj periudhe të behet auditimi i përmbushjes së zotimeve për tërë periudhën .

Kontrata me spin off Special është e nënshkruar me dt. 27.08.2007 , zotimet për investime 8,600,000.00 € , zotimet për punësim kanë qene 80 punonjës në gjashtë muajt e parë , 173 në fund të gjashtë muajve , 345 në fund të 12 muajve , 345 punonjës të mbahen përgjatë vitit të dytë dhe kjo kompani nuk është liruar ende nga monitorimi i AKP-së. Ndërsa sipas raportit të auditimit që është bërë nga kompania „ Audit AK “ për periudhën 27.08.2007 deri me 31.12.2014 kompania ka bërë investime kapitale në vlerë prej 7,045,713.00 € nga 8,600,000.00 € të zotuar ose 81.93% , punësimi për dy vitet e para 65.01% kurse për periudhën nga 27.08.2007 deri me 31.12.2014 përmbushja ka qenë 21.14% .

Ndërsa marrëveshja e zotimeve është e rregulluar me nenin 10.13.2 i cili parasheh si në vijim „ Për sa kohë zgjatë kjo marrëveshje , as blerësi e as ndërmarrja nuk mundet pa miratimin paraprak me shkrim të AKP-së (mosmiratimi eventual i kësaj natyre nuk duhet të behet pa arsye) për ndërmarrjen e veprimeve si me poshtë :

- a) të delegoj të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas kësaj marrëveshje ,
- b) të ndryshoj pronarët përfitues apo personat kontrollues (pasi këto janë kushtet e përcaktuara në rregulloren e tenderit) për blerësin,
- c) të ndryshoj strukturën e pronësisë së ndërmarrjes ose
- d) bashkoj apo bartin asetet apo veprimtaritë e biznesit të ndërmarrjes tek një tjetër entitet “.

AKP-ja konfirmon se në bazë të informatave në dispozicion, nuk kanë ndonjë dëshmi se blerësi ka bërë ndonjë herë kërkesë për hipotekë apo shitje të pronave , ndërkaq ka bërë kërkesë për transferim të aksioneve në mes të aksionarëve ku një kërkesë e tillë iu është aprovuar nga ana e bordit të AKP-së me datë 08.07.2011 dhe sipas këtij vendimi aksionar „ QMI “ ka 30% të aksioneve ndërsa tjetri aksionar „ Fantinelli “ 70% të aksioneve.

Gjithashtu me 07.08.2012 njëri nga aksionaret ka kërkuar pëlqimin nga Bordi i AKP-së për ndërrimin e përqindjeve të aksioneve sipas vendimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut , ku „ QMI “ do të kishte 81.25% të aksioneve kurse tjetri aksionar „ Fantinelli “ 18.75 % të aksioneve . Kjo kërkesë nuk është miratuar nga ana e Bordit të AKP-së.

Prova : Materiali i përgjigjes te pranuar nga AKP-ja te datës 23.05.2016.

Me datë 23.05.2016 kemi bërë kërkesë AKK-së me nr. Ref .06/1-02/SHF/226-2016 (Agjensionit Kadastral të Kosovës) ku kemi kërkuar që te verifikoj në regjistrin e të drejtave pronësore se a ekzistojnë patundshmëri të regjistruara në emër te personit fizik e juridik si dhe te bizneseve : Haziz Tafaj dhe bizneseve „ Agrokosova Hollding dhe „ QMI-së”.

Me date 23.05.2016 kemi pranuar përgjigjeje nga AKK-së (Agjensionit Kadastral të Kosovës). Personi juridik „QMI” Qendra e mobileve Italiane Sh.p.k. nuk është e evidentuar ne Regjistrin e Drejtave të Pronës së Paluajtshme .Ndërsa personi fizik Haziz Tafaj dhe biznesi „ Agrokosova Hollding “ janë të evidentuar ne Regjistrin e te drejtave të Pronës së Paluajtshme.

Me date 24.05.2016 kemi bërë Raport Informues me nr. Ref .06/1-02/SHF/231-2016 për Prokurorinë Themelore Prizren ku janë njoftuar për veprimet e me tutjeme hetimore.

Prova : Raporti informues i datës 24.05.2016

Me date 24.05.2016 kemi bere kërkesë me nr. Ref .06/1-02/SHF/232-2016 Prokurorisë Themelore në Prizren ku kemi kërkuar qe na baze te nenit 105 par 3 te KPPRK-së ti drejtohen Gjyqtarit të Procedurës Paraprake qe ti parashtroj kërkesë për kontroll dhe sekuestrim të përkohshëm , e krejt kjo me qëllim që me rastin e kontrollit te mblidhen provat dhe dëshmi shtesë të cilat do të sekuëstrohen dhe ne fazën e mëtutjeshme të përdoren si provë kundër te dyshuarve ne fjalë apo te dyshuarve te tjerë .

Prova : kërkesa për Prokurorin Themelore në Prizren të datës 24.05.2016

Me date 24.05.2016 nga Gjykata Themelore ne Prizren kemi pranuar Urdhëresën për Urdhër kontroll për kontrollimin e shtëpisë - banesës , lokaleve të tjera përcjellëse , automjeteve dhe mjeteve të tjera motorike si dhe ne ndërtesën ku gjendet zyra e bizneseve „ Agrokosova Holldin “ me seli ne fshatin Shirok KK- Suharekë dhe ne zyret e „ QMI-së” Sh.p.k. me qendër në Lipjan dhe ne shtëpinë e banimit e të dyshuarit Aziz Tafaj në fshatin Gelancë KK Suharekë.

Me datë 25.05.2016 ne kemi zbatuar urdhëresën nga Gjykata Themelore ne Prizren për Urdhër kontroll dhe kemi kontrolluar : Zyret e bizneseve „ Agrokosova Holldin “,zyret e „ QMI-së” Sh.p.k. dhe shtëpinë e banimit e të dyshuarit Aziz Tafaj ku janë sekuestruar disa dokumentacione ne cilesin e provave materiale të cilat do ti bashkëngjisim Kallëzimit Penal .

Provë:Raporti informues ,urdhëresa me nr..... per kontrollim dhe sekuestrim,procesverbalet mbi kontrollimin

Me datë 25.05.2016 është intervistuar personi Haziz Tafaj ne cilësin e të dyshuarit i cili deklaroi se pozita e tij ne kompani ka qenë si përfaqësues i QMI-së , nënshkruer i marrëveshjes së zotimit së bashku me partnerin tjerët Gruppo Vinicollo Fantinell të përfaqësuar nga Giafranco Fantinell me ç raste edhe është fituar tenderi për privatizimin e ndërmarrjes „NBI” -Suharekë tani Newco e privatizuar në procesin e privatizimit të ashtuquajtur me Spin of Special , në ate marrëveshje palët obligohen pra QMI-a dhe Fantinelli që ti paguaj shumën prej 4,170,000.00 € për afërsisht është kjo shumë , që ti investoj 8,600,000.00 € dhe ti punësoj një numër të caktuar të punëtorëve , procesi i privatizimit është kryer në mënyrë të rregullt dhe është bërë transferi i aksioneve dhe i pronës nga AKM-ja te Newco dhe është filluar aktiviteti në ndërmarrjen e re , që nga fillimi personat e autorizuar kemi qenë unë dhe Giafranco Fantinell mirëpo nga gushti i vitit 2007 e deri në prill të vitit 2008 ndërmarrja është menaxhuar nga Fantinelli dhe Habib Usaj si personi i deleguar i tij që për këtë menaxhim nuk kam pas vërejtje deri kur janë zbuluar disa veprime të dëmshme për ndërmarrjen nga ana e Fantinellit dhe vartësit e tij dhe për të cilat veprime ende është duke u zhvilluar një procedurë

Penale në Gjykatën Themelore në Prizren tani kundër të akuzuarit Habib Usaj dhe Gianfranco Fantinell.

I dyshuari Haziz Tafaj deklaroi se për llogarinë e hapur në TEB Bankë ku sipas tij prej fillimit ka punuar me të njëjten llogari që është hapur në TEB nga kompania QMI shpk dhe të gjitha investimet janë bërë nga e njëjta llogari për nevojat e kompanisë Agrokosova Holding Shpk, arsyeja e hapjes së kësaj llogari është se një llogari e hapur nga ana e z.Fantinellit dhe Habib Usaj në Raiffeisen Bank ka qenë e bllokuar për QMI-në nga ana e vet Z.Fantinell dhe për të njëjtën llogari është duke u zhvilluar procedurë penale kundër përfaqësuesve të GVF, arsyeja e dytë sipas tij që është edhe me e rëndësishme për përmbushjen e marrëveshjes së zotimit dhe me lejen e pronarit të QMI-së në pajtim edhe me AKM-në është hapur llogaria e QMI-së për investime në ndërmarrjen e Agrokosova Holding, nga ajo llogari janë kryer të gjitha investimet në ndërmarrjen Agrokosova Holding, janë kryer pagat e punëtorëve dhe ajo llogari ka qenë publike e raportuar në të gjitha institucionet e shtetit përfshirë edhe ATK-në, AKP-në si dhe të gjitha fakturimet dhe pagesat e bera nga ajo llogari ju kanë nënshtruar edhe një raport të kontrollit nga agjensia e të hyrave nga ATK-ja dhe si rezultat i saj ka rezultuar me një rimbursim nga ATK-ja në vlerë rreth 600,000 euro. Ndërsa në llogarinë bankare të Agrokosovës e cila ka qenë e hapur në Raiffeisen Bankë nuk ka pasur qasje asnjëherë as ai e as ndonjëri nga përfaqësuesit e QMI-së

Vlen të ceket se i dyshuari ka deklaruar se objektin të cilin e kanë pasur në pronësi afër Lipjanit ku ka qenë selia kryesore e QMI-së në vitin 2010 është bërë shitja e atij objekti të cilin kontratë të shitblerjes është mbetur ta sjellë i dyshuari.

I dyshuari Haziz Tafaj gjat intervistimit deklaroi se asnjë pasuri nuk është lënë peng nga ana e tij e as nga kompania që e përfaqëson nuk është lënë në kolateral e as nuk është shitur e as që është tjetërsuar, ndërsa për kontratën e shitjes së Inoxi-it ai ka deklaruar se Fantinelli dhe Habib Usaj kanë lidhur kontratë me firmën „Mont Metal“ të Malit të Zi ku sipas tij edhe për këtë është duke u zhvilluar një procedurë penale në Gjykatën Themelore në Prizren kundër Habib Usaj dhe Fantinellit.

Sa i përket lënjes peng në Bankën Ekonomike I dyshuari ka deklaruar se borxhi është marrë në emër të firmës QMI Shpk dhe për këtë kemi konfirmim të formës së prerë të Gjykatës Supreme, këto mjete janë marrë për pagesën e paisjeve nga furnitori Gortani dhe të tjerat janë paguar në doganat e Kosovës dhe për këtë kemi dëshmi, këto paisje me vlerë mbi një milion euro të paguara në tersi nga kompania QMI-SHPK për Agrokosova Holding edhe tani janë pjesë të aseteve të ndërmarrjes Agrokosova Holding të cilat rezultojnë edhe nga ekspertiza e Gjykatës Ekonomike në Prishtinë, ndërsa sa i përket pengut që është lënë në Bankën Ekonomike me sa e din nuk është e ndaluar e sidomos kur bëhet në interesat e ndërmarrjes e jo në dëm të saj sepse në bazë të deklaratës së transferit nr 981/2007 e datës 27.08.2007 në faqen dhjetë ky veprim është i lejuar.

Ndërsa sa i përket marrëveshjes të datës 11.11.2010 në mes Haziz Tafaj dhe Fadil Demiri ku bëhet fjalë për disa paisje që nuk janë në përdorim-shfrytëzim të ndërmarrjes dhe pasi që janë konstatuar se të njëjtat nuk kanë qenë në gjendje të mirë ato paisje i kanë dhënë në shfrytëzim të njëjtit person deri në vitin 2015, ku ekziston dokumenti që janë dhënë në shfrytëzim e nuk janë shitur dhe të njëjta paisje sipas tij personi Fadil Demiri kishte kërkuar që të shkojnë të marrin por në mungesë të transportit kishin mbetur ende pa u terhequr.

Avokati mbrojtës i të dyshuarit në fund të deklaratës ka shtuar për faktet me shkrim me qëllim të bashkëpunimit në këtë rast do të dorëzojmë të gjitha provat që i kemi.

Vlen të ceket se në disa herë kemi kontaktuar në telefonin celular të Avokatit Naim Qelaj si dhe personin e dyshuar Haziz Tafaj që të na sjellin dëshmitë për të cilat vet kanë deklaruar por asnjëherë nuk e kanë hapur telefonin dhe nuk i kanë sjellë dëshmitë e cekura më lartë.

Ndersa pas analizimit te dokumentacionit qe jan sekuestruar me rastin e kontrollimit ne baz te urdheresës per kontrollim vlen te ceket se jan gjetur disa kontrata si ajo mes Haziz Tafaj dhe Fadil Demiri, kontrata dhe deklarata per shitblerjen e podrumit te veres ne Suharekë ne mes Haziz Tafaj dhe Blerim Kuqi dhe kontrata - marrveshje te ngjajshme.

Prova : Deklarata e të dyshuarit Haziz Tafaj te dt.25.05.2016, Aktvendim për pushimin e hetimit, Deklarata e Transferit nga AKP-ja te dt. 27.08.2007.

Me datë 26.05.2016 i kemi përpiluar dhe dorëzuar raportin informues me nr. Ref .06/1-02/SHF/235-2016 per Prokurorinë Themelore në Prizren në lidhje me zbatimin e Urdhërësës me nr.Pndr.nr.33/2016.

Me date 20.05.2016 kemi bërë kërkesë NJIF-K me nr. Ref .06/1-02/SHF/225-2016 që të na sigurojnë informata lidhur me personin Haziz (Zeqir) Tafaj dhe bizneset „Agrokosova Holding“ , „QMI„ Qendra e mobiljeve Italiane Sh.P.K. Kemi kërkuar të gjitha llogarit bankare të hapura në Kosovë në emër të tyre dhe si autorizues të ndonje llogarie bankare apo bizneseve dhe të gjitha të dhënat e llogarive bankare : emrin e bankave dhe nr. i llogarive.

Me date 30.05.2016 kemi pranuar përgjigjeje nga NJIF-K . ne te cilen pergjigje ceket se Haziz Tafaj ka te hapur llogari bankare ne : NLB bankë, Banka Private të Biznesit ku është i autorizuar ,Raiffesen Bankë është i autorizuar ,Banken Kombëtare Tregtare është i autorizuar, ProCredit Bankë mbajtes i llogarisë dhe i autorizuar ,Banken Ekonomike mbajtes i llogarisë dhe i autorizuar ,Turk Ekonomi Bankasi (TEB) mbajtes i llogarisë dhe është i autorizuar .

Biznesi „ Agrokosova Holding “ ka të hapur vetëm një llogari bankare ne Raiffesen Bankë persona te autorizuar janë Gianfranco Fantinelli , Sami Ademi dhe Habib Usaj.

Biznesi „ QMI“ Sh.p.k. ka te hapur llogari bankare ne : NLB - Prishtina , Raifesen Bankë, Banken Private të Biznesit , ProCredit Bankë , Bnaken Ekonomike, TEB bankë.

Me date 31.05.2016 kemi bërë kërkesë me nr. Ref .06/1-02/SHF/242-2016 Prokurorisë Themelore të Prizrenit që në bazë të nenit 87 par 1.12 tëKPPRK-së ti drejtohet Gjyqtarit të Procedurë Paraprake duke parashtruar kërkesën për mbledhjen e të dhënave financiare nëpër bankat të cilat operojn në Kosovë.

Me date 07.06.2016 kemi pranuar Urdhëresë nga Gjykata Themelore në Prizren për masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit për zbulimin e të dhënave financiare , verifikimi I xhirollogarisë bankare , ku edhe janë shpërdarë nëpër banka .

Me date 24.06.2016 kemi bërë Raportë Informues me nr ref 06/1.02/SHF/270/2016 për Prokurorinë Themelore Prizrenë lidhur me Zbatimin e udhërësës Pndr,nr.59 /2016 për masë e fshehtë zbulimi I të dhënave financiare

Me date 18.07.2016 kemi pranuar Urdhëresen nga Prokuroria Themelore në Prizren me nr.PP.nr.255/2015 që materiali I grumbulluar nga bankat ti analizoj Eksperti për qështje financiare që veprojn ne kuadër te DHKEK (Drejtoria e hetimeve e krimeve ekonomike dhe korrupsionit).

Me date 15.11.2016 kemi pranuar kerkesën nga Prokuroria Themelore në Prizren ne lidhje me veprimet hetimore te cilat jane ndermarr nga ana e jonë.

Me date 25.11.2016 kemi përpiluar dhe dorezuar Raportin Informues me nr . ref 06/1-02/SHF/505-2016 , Prokuroris Themelore në Prizren ku edhe është njoftuar në lidhje me veprimet e ndërmarrura hetimore.

Me date 30.11.2016 kemi pranuar raportin e Analizës Financiare nga Eksperti Financiar në DHKEK - DPP-Prishtinë, ky raport i cili paraqet gjendjen e llogarive bankare dhe qarkullimin financiar, në bankat komerciale në Kosovë, të disa subjekteve dhe personave, llogari bankare që janë menaxhuar nga Haziz Tafaj, dhe personave të lidhur me këto subjekte. Në raportin e analizës financiare janë paraqitur lëvizjet e mjeteve financiare, duke përfshirë transferet hyrëse dhe deponimet, në të gjitha llogaritë bankare, pastaj transferet-pagesat dhe tërheqjet e mjeteve financiare, në llogaritë e subjekteve dhe të personave, të cilët kanë qenë, pronarë, bashkëpronar-ortak apo të autorizuar në llogaritë e këtyre subjekteve afariste.

1 Bazuar në raportin analizë financiar në TEB Bankë në numrin e llogarisë rrjedhëse [redacted] nga viti 2012/2014 janë pranura SUBVECIONE në vlerë 1,316,468.98 euro.

2 Në bazë të dokumentacionit financiar, Haziz Tafaj në emër të subjekteve: Agrokosova Holding dhe QMI, me dt.22.03.2010 kanë aplikuar në Bankën Ekonomike për Mbitërheqje -Overdraft në vlerë 230,000.00 €, e cila kërkesë ishte aprovuar sipas vendimit nr.429 të bankës Ekonomike. Kështu mjetet e aporovuara për mbitërheqje-OVD, subjekti QMI me dt.23.03.2010 i kishte transferuar 225,432.00 € Pagesë 02/2010 në AQF- (ATK), prej datës 23.03.2010 e deri me dt.28.10.2011 në emër të mbulimit të mbitërheqjes në llogari të QMI-së janë transferuar-deponuar 116,021.00 €. Sipas raportit bankarë sub. QMI deri me dt.26.09.2012 në emër të mbitërheqjes -OVD ka pasur obligim financiarë 139,264.91 €, kësaj vlerë financiare banka Ekonomike i'a ka shtuar edhe interesin për mbitërheqje në vlerë 44,038.31 €. Lidhur me këtë rast Banka Ekonomike ka parashtruar padi në GJ,TH. Në Prishtinë kundër subjektit QMI për përmbushjen e obligimeve bankare (139,264.91+ 44,038.31) në vlerë 183,303.22 €. Në bazë të vendimit IC nr.77/2012 të GJTH - Prishtinë, me dt.19.10.2012 Banka Qendrore në llogarinë e klientit QMI # [redacted], ka bërë shlyrjen e kredisë dhe interes sipas rregullores IX të BQK-së në vlerë 183,303.22 €.

Prova: Raporti informues, kërkesa për zbulim të dhenave financiare, Urdhëresa për masë të fshehta -zbulim I të dhenave financiare, Kërkesa për Ekspertin Financiar në DHKEK -DPP-Prishtinë të dt.20.07.2016, Analiza Financiare nga Eksperti Financiar në DHKEK -DPP- Prishtinë.

3 Me date 27.12.2016 kemi bërë kërkesë AKP-së me nr.ref :06/1-02/SHF/ 543-2016 për marrjen e informatave për biznesin „ Agrokosova Holding “ SH.P.K. kemi kërkuar Raportin e auditimit (të fundit) lidhur me ndërmarrjen „ Agrokosova Holding “ i cili është dorëzuar në AKP , procesverbalin ose raportin lidhur me takimin e mbajtur në mes AKP-së dhe auditorve ku është diskutuar për ndërmarrjen „ Agrokosova Holding “ .

Me datë kemi pranuar përgjigjejen nga AKP-ja dhe kemi pranuar Raportin e Auditimit të ndërmarrjes „ Agrokosova Holding të dates 01.04.2015 gjithashtu kemi pranuar raportin lidhur me takimin e mbajtur në mes të pëfaqësuesve të AKP-së dhe kompanisë Audituese . Sipas Raportit të Auditimit të ndërmarrjes „ Agrokosova Holding “ të dates 01.04.2015 , lidhur me pagesën e investimeve një pjesë e tyre është bërë përmes llogarive bankare , ndërsa pjesa dërmuese është prezantuar si kompensime më pasuri të patur lëshme , ndërsa kontratat e prezantuara nuk janë të vërtetuara në Gjykatë . Patundëshmërit e transferuara kanë qenë në pronësi të Aziz Tafaj , janë bartur te punëkryersi dhe kreditorët tjerë në emër të shlyerjes së borxheve ndaj kreditorëve të Agrokosova Holding “ .

Punësimi i zotuar për dy vitet e para të Marrëveshjes së Zotimit është realizuar për 65.01% ndërsa në total prej 27.08.2007 e deri me 31.12.2014 është realizuar për 21.14%.

4 Pagesa e tatimit në të ardhura personale për muajin 09/2009 deri 05/2013 është bërë përmes kompensimit nga teprica kreditorë e tvsh-së me rastin e rimbursimit të sajë .

Pagesa e kontributeve pensionale për muajt 09/2009 deri 05/2013 është bërë përmes kompensimit nga teprica kreditore e tvsh-së me rastin e rimbursimit të saj.

Totali i kopensimeve për dy obligimet e lartëshenuar është në shumën prej 202, 910.80 euro .

Për muajin Korrik dhe Gushtë 2014 nuk janë paguar tatimi në paga dhe as kontributet pensionale, ndërsa për muajin Shtator dhe Tetor 2014 të njëjtat nuk janë deklaruar fare . Lidhur me punët e bëra nga punëkryersi „ Termoteknika “ Prizren , Ndërmarrja ka paraqitur një faturë në vlerë prej 133,155.00 € për 21 puse për të cilat është pretenduar se janë hapur .

Me rastin e ekzaminimit të punës në terren së bashku me agronomët e ndërmarrjes kanë gjetur 13 puse të hapura. Shumën e vlerësuar e investimeve për këto punë të kryera në terren ka qenë 78,650.00 € .

Pagesat e paraqitura për punimin e shpuarjes së puseve janë : Në TEB Bankë ku janë bërë pagesa në shumë prej 5,000.00 € dhe një faturë në emër të kompensimit me derivate naftë në shumë prej 34,500.86 € . Pjesa tjetër e pagësës është bërë përmes kompensimit me patundshmëri me një kontratë e cila nuk është vërtetuar në Gjykatë .

Te punëkryersi „ Dili Comerc “ Prizren , faturat në shumë prej 1,610,684.00 € të cilat janë lëshuar në emër të kryerjes së punimeve në zonën agrare Gelancë në emër të punimeve të kaskadave zonave për rreth rrugës kryesore në Biraq dhe ndërtimit të infrastrukturës rrugore për agroturizëm .

Me rastin e inspektimit të punës në terren së bashku me agronomët e „ Agrokosova Holding “ janë konstatuar se përpos meremetimit të një trasje rrugore me gjatësi prej 1,400 m në vlerë prej 130,772.80 € , punimet tjera në zonat e cekura më lartë nuk janë kryer .

Menyra e kompensimit të punimeve nga punëkryersi është bërë me një kontratë mbi shtëblerjen e patundshmërisë , pasurit e transferuara nuk kanë qenë në emër të Agrokosova Holding por kanë qenë në emër të Aziz Tafaj .

Prova : Kërkesa për AKP-në të dt. 27.12.2016, pergjigja nga AKP-ja, Raporti i Auditimit të dt.01.04.201

Me datë 24.01.2017 është intervistuar në cilësi të dëshmitarit Agim Kastrati auditor i kompanisë audituese NSH „ Audit AK “ i cili deklaroi se e ka bërë raportin e auditimit të datës 01.01.2015 i cili ka qenë specifik për kompaninë „ Agrokosova Holding “ në vitin 2014 për periudhat audituese nga viti 2007 e deri në vitin 2014 . Sipas deklaruësit prej dokumentacionit që ne kemi hasur që nuk ka qenë në rregull janë investimet e prezentuara nga kompanija të bëra nga punëkryesi Dili Komerc në shumën prej 1,610,684.00 € ku për këto investime ekzistojnë faktura nga punëkryesi por të njëjtat punime kur kemi dalë në terren nuk kanë mundur të na i prezantojnë askund . Njera nga detyrat e auditorit sipas deklaruësit ka qenë që dokumentacionin e prezentuar të investimeve ta vërtetojmë se a është bërë me të vërtetë në terren. Gjithashtu sipas dëshmitarit nga agronomët e kompanisë i ishëm ofruar procesverbale të punës në terren ku edhe kishin vërtetuar se nuk ishin kryer nga punëkryesi dhe vlera e investimeve nga Dili Komerc nuk ishte ajo që ju ishte prezentuar por është vlera 151,696.42 euro, kontratën për infrastrukturë rrugore në vreshta , me ndihmën e agronomëve të kompanisë auditori ka konstatuar se nga 1,600,000.00 € sa kanë qenë të prezentuar punët sipas fakturave janë realizuar vetëm 130,773.00 € , dallimi tjetër është të investimet e prezentuara nga kompania termoteknika, kompania Agrokosova ka të nënshkruar një kontratë për hapjen e puseve në vreshta ku vlera e kontratës është 535,450.00 euro , për punët e kryera në terren ju ishte prezentuar një faturë në shumën 133,155.00 euro , kjo faturë ka pasur të bëjë me hapjen e 21 puseve , me rastin e inspektimeve në terren së bashku me agronomët e kompanisë kishin gjetur se janë hapur gjithsej 13 puse në vlerë 78,650.00 euro. Sipas

dëshmitarit auditorët tjer kishin pranuar shumen qe ishte ne kontrat por auditori ne fjal edhe pas inspektimit te punëve ne teren nuk kishin hasur tjera te hapura.

Parregullsi tjetër qe kishin vrejtur se kompania ka prezentuar investime jasht planit investiv qe nuk kishin te bejn me kete kompani siq ishte rasti per paisje per industri te qumështit ne vler prej 156,695.30 euro. Gjithashtu e permenden se kompania ka pas obligim punësimin e punetorve por edhe ktu sipas auditorit nuk e kishte përmbush kete detyrim ne tersi por vetëm 65,01% per dy vitet e para ndersa per gjith periudhen ne total është vetëm 21.14% e punsimit. Gjithashtu parregullsi qe kishin vrejtur gjat krahasimit te dokumentacionit qe ju kishte ofruar kompania dhe verifikimit ne teren kishin vrejtur se njeri nga eskavatoret qe kan qenë te cekur ne dokumentacion gjat verifikimit ne teren njërin nga ta nuk eshte hasur.

Provë : Deklarata e dëshmitarit Agim Kastarti i dt.24.01.2017, Procesverbali i Agronomëve , Njoftimi për AKP-në.

Ne vazhden e veprimeve hetimore jan intervistuar edhe auditoret e tjer te cilet ne raportin e tyre kan cekur te gjeturat por qe vlen te ceket se te gjitha te gjeturat I kan bazuar vetem ne dokumentacionin e ofruar nga kompania AgroKosova por jo edhe nga inspektimi i puneve te kryera ne teren.

Provë: Deklarata e dëshmitares Besa Berisha te dt.27.01.2017, Deklarata në cilësin e dëshmitarit Nijazi Junuzi i dt.27.01.2017, Deklarata në cilësin e dëshmitarit Liman Morina i dt.30.01.2017

Me datë 01.02.2017 kemi bërë kërkesë Drejtorisë Kadastrale -Prishtinë dhe Drejtorisë Kadastrale - Suharekë , kemi kërkuar që të na sigurohen të dhënat lidhur me historikun e regjistrimit të parcelave me dokumentet e dorëzuara nga pala , vendimet -fletë posedimi , certifikatat mbi të drejtat e pronës së palutëshme për secilin njësi të lëshuar nga ZKK-ja qdo barr mbi pronën dhe informacionet e mundëshme të hipotekave per parcelet private te Haziz Tafaj dhe parcelet te subjekteve „ QMI-së “ dhe të „ Agrokosova Holding “ .

Me datë 10.02.2017 kemi pranuar përgjigjeje nga Drejtoria Kadastrale -Prishtinë për dy parcela te cilat gjenden ne Zonen Kadastrale ne Matičan . Me datë 16.11.2011 parcelat kadastrale : 930-187 ,930-188 ,930-189 ,930-7 ZK. Matičan kanë kaluar në pronësi të Haziz Tafaj , sipas Aktvednimit me nr: 011-952-1-1822 , dt,16.11.2011 të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit në Prishtinë .

Me datë 14.02.2017 kemi pranuar përgjigjeje nga Drejtoria Kadastrale - Suharekë për nëntë parcela ne ZK-së Gelancë -Suharekë të cilat janë pronë private të familjes Zeqir Bajram Tafaj prej vitit 2003-2004 ndërsa në vitin 2012 me aktëvendim kalojn te Haziz Tafaj 1/3 , Habib Tafaj 1/3 dhe Hamit Tafaj 1/3 .

Ndërsa Zonat Kadastrale : Gelancë për 62 (gjashtëdhjete e dy) Parcele , Gjinoc 25 (njezetë pesë) parcele ,Leshan 22 (njëzet e dy) parcele , Suharekë 117 (njëqindë e shtatëmbëdhjet) parcele , Sopijsë 35 (tridhjet e pesë) parcele , Dubravë 12 (dymbëdhjet) parcele , Savrov 84 (tetëdhjet e katër) parcele , Sallagrazhdë 2 (dy) parcele , të gjitha këto parcele i kan takuar Pasurisë Shoqërore : NBI Suharekë , në bazë të Kosova Trust Agency - Agjensionit Kosovar i Mirëbesimit Prizren me nr. 72/688108 i datës 15.01.2008 si dhe Autorizmin e Habib Selamn Usaj nga Gelanci dhe Dekalratat e transferit Pa .nr.981/2007 i datës 27.08.2007 këto prona kanë kaluar në emër te „Agrokosova Holding “ Sh.P.K. Suharekë për qiramarrje për 99 vjetë .

Përfundim

Faqe 16 nga 22

Adresa: Rr. Luan Haradinaj pn. 10000 Prishtinë – Kosovë,
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës,

Në përfundim të kësaj çështje pasi që kemi analizuar dhe shqyrtuar të gjitha shkresat e kësaj lënde duke i vlerësuar dhe çmuar të gjitha provat materiale të siguruara gjatë procedurës së zhvilluar kemi ardhur në përfundim se:

a) Haziz Tafaj dyshohet për veprën penale falsifikim i dokumenteve zyrtare nga Neni 434 par.1 të KPK. Haziz Tafaj (aksionar pakicë 30%) dyshohet se ka falsifikuar nënshkrimin e Giafranco Fantinell (aksionar i shumicë 70%) në statutin e shoqërisë „ Agrokosova Holding “ ku me pas të njejtin statut ne vazhdimesi e ka perdorur - prezentuar me qellim te perfitimit personal ku ka arritur qe permes te njejtin statut te marr ne menaxhim duke bërë padi ne Gjykatën Ekonomike ne Prishtinës për ndryshimin e përqindjes së aksioneve dhe me datën 11.06.2012 Gjykata vendos në favor të Aziz Tafes me 81% për QMI-në ndërsa 18.75% GVF. Ky vendim është anuluar me një aktvendim të Gjykatës së Apelit të datës 18.02.2014 dhe gjendja kthehet në gjendjen e mahershme.

b) Haziz Tafaj në cilësi të përfaqësuesit të njërit aksionar nga viti 2007 e deri në vitin 2014 në ARBK bënë ndryshime në poziten e tij të punës duke filluar sipas statutit të „ Agrokosova Holding “ është si administrator herë si drejtor , herë si antarë bordi dhe i cili bënë ndryshime dhe në Aneks Statutin e Biznesit .

c) Në TEB bankë është hapur një llogari rrjedhëse e kompanisë QMI me nr :20-26-0000084644-80, në aplikacionin e hapjes së llogaris e kanë nënshkruar Ivonios Doimo dhe Haziz Tafaj , ndërsa llogaria e dyte me date 18.03.2009 është hapur llogaria bankare në TEB bankë në emër të QMI-së me nr [redacted]

d) Në bazë të dokumentit nga Ministria e Bujqësisë , Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ku kompania „ Agrokosova Holding “ sh.p.k ka aplikuar për subveçione - pagesa direktet për vreshta me sipërfaqe prej 313.47 ha në AZHB, në emër të Haziz Tafaj nga fshati Gelancë , Komuna e Suharekës e ka subvencionuar me shumë të përgjithëshme prej 62,694.00 € dhe mjetet janë alokuar në xhirollogarin bankare me nr [redacted] në TEB bankë me dt.12.11.2013.

e) Nga ATK-ja Aprovohet rimbursimi dhe i është dhënë urdhërpages zyrtare për Departamentin e Thesarit për kërkuesin „ Agrokosova Hollding “ pronar Aziz Tafaj ku shuma prej 596,624.11 euro të rimbursohen në xhirollogarin me nr [redacted] në TEB Bankë. Shuma e aprovuar i referohet Aplikacionit të Rimbursimit me nr.1961881 të datës 11.10.2013.

Sipas AKP-së marrëveshja e zotimeve është e rregulluar me nenin 10.13.2 i cili parasheh si ne vijim : „ Për sa kohë zgjatë kjo marrëveshje , as blerësi e as ndërmarrja nuk mundet pa miratimin paraprak me shkrim të AKP-së (mosmiratimi eventual i kësaj natyre nuk duhet të behet pa arsye) për ndërmarrjen e veprimeve si me poshtë :

- a) të delegoj të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas kësaj marrëveshje ,
- b) të ndryshoj pronarët përfitues apo personat kontrollues (pasi këto janë kushtet e përcaktuara në rregulloren e tenderit) për blerësin,
- c) të ndryshoj strukturën e pronësisë së ndërmarrjes ose
- d) bashkoj apo bartin asetet apo veprimtaritë e biznesit të ndërmarrjes tek një tjetër entitet .

Me date 22.03.2010 Haziz Tafaj lidh marrëveshje kreditore me Bankën Ekonomike në Prishtinë për mbiterheqje për biznes në shumë prej 230,000.00 euro në afat prej 6 (gjashtë) muaj , ku huamarrsi është „Agrokosova Hollding “ Sh.p.k. „ QMI “ sh.p.k. të cilën e përfaqëson Haziz Tafaj me nr id. [redacted]

Aziz Tafaj e autorizon vetën si shrytëzues i OVD-së ne firmen „ Agrokosova Holding” sh.p.k. „ QMI shpk. Fshati Suhodoll - Lipjan të cilën e përfaqëson Aziz Tafaj - shfytëzuesi i cili autorizon dhe pajtohet që Bankes Ekonomike sh.a Prishtinë ti lë -ofroj në formë të pengut të autorizuar pasurin e palujtëshme Parcelën e cila ndodhet në vendin e quajtur Shirokë sipas fletës poseduese UL-72116046-01019, me Ngastrat Kadastrale parcelat P-72116046-02665-0, 02666-0, 02671-2, 02671-3, 02677-2, 02678-2, 02679-1, 02680-2, 02681-1, 02682-0, 02683-2, 02684-0, 02685-0 me gjithësesjt 6.74.41 m² e cila është evindentuar në Zonën Kadastrale në Suharekë , lenë pengë 5-gjenarator, 3-nxemëse , goma mbajtëse , skele për ndërtimtari (Reklam) , mbajtëse të reklamave , frigorifer candy 240L, Tavolina me pjesë percjellëse , karrika , rafta , inventar te restorantit dhe zyreve te administrates , softëeer , automjete , paisje percjellëse për sector të shitjes , 8 - Serbator nga qeliku për verë, mall ne depot ë QMI-së . Këtë patundëshmëri (pasuri e „ Agrokosova Holding” shpk. „QMI” shpk.Fshati Suhodoll - Lipjan) të cilën e përfaqëson Aziz Tafaj .

Shrytëzuesi e lenë kolateral për OVD-në në vlerë 230,000.00 € si siguri pagesën e OVD-së me afat kthimi për 6 muaj .

Vlera e Patundëshmëris së lenë peng nga komisioni i Bankës është vlerësuar në 1,348.820.00 € Nga Banka Ekonomike është aprovuar për Mbiterheqje -Overdraft në vlerë 230,000.00 €, e sipas vendimit nr.429 të Bankës Ekonomike. Kështu mjetet e aprovuara për mbiterheqje-OVD, subjekti QMI me dt.23.03.2010 I kishte transferuar 225,432.00 € Pagesë 02/2010 në AQF- (ATK), prej datës 23.03.2010 e deri me dt.28.10.2011 në emër të mbulimit të mbiterheqjes në llogari të QMI-së janë transferuar-deponuar 116,021.00 €. Sipas raportit bankarë sub. QMI deri me dt.26.09.2012 në emër të mbiterheqjes -OVD ka pasur obligim financiarë 139,264.91 €, kësaj vlere financiare banka Ekonomike i'a ka shtuar edhe interesin për mbiterheqje në vlerë 44,038.31 €. Lidhur me këtë rast Banka Ekonomike ka parashtruar padi në GJ,TH. Në Prishtinë kundër subjektit QMI për përmbushjen e obligimeve bankarë () në vlerë 183,303.22 €. Në bazë të vendimit IC nr.77/2012 të GJTH - Prishtine, me dt.19.10.2012 Banka Qendrore në llogarin e klientit QMI # . ka bërë shlyrjen e e kredisë dhe interesit sipas rregullores IX të BQK-së në vlerë 183,303.22 €.

Haziz Tafaj me datë 16.12.2010 lidh kontratë mbi shitblerjen e inoksit të dëmtuar hekur mbeturinë tërheqje e paisjeve dhe pastrimin e podrumit në vlerë prej 120,000.00 € (njëqind e njetzetmij Euro) , kontrat e lidhur ne mes të :

- 1 „ Agrokosova Holding” Sh.p.k. Shirokë -Suharekë , me nr; fiskal 600281969 të cilën e përfaqëson administratori Haziz Tafaj me nr te Id (si shitës) dhe
- 2 „Biopak” sh.p.k. nga Rahoveci me nr .fiskal:600061569 të cilën e përfaqëson derjtori Nusret Haxhi murati menr ID; 1016260912(si Blerës) .

Haziz Tafaj me date 10.11.2010 lidh marveshje ne emër të „ Agrokosova Holding ” i cili ia shet tanqet (rezervuaret) Fadil Demirit nga Mushtishti ne vlerë prej 10,000.00 euro :

- 2 (dy) tanqe ne volum prej 25.000 litra .
- 3(tri) tanqe prej 8.500 litra .
- 2 (dy) tanqe prej 3.900 litra.
- 1 (një) tank prej 2.000 litra.
- 1 (një) tank prej 1.000 litra.
- 1 (një) tank prej 20.000 litra.

Ekzistoj dy deklarata njëra është e Haziz Tafaj dt; 11.12.2013 i cili deklaroi se mjete e pranuar në llogarin private të tij me nr. [redacted] në TEB bankë janë të hyra nga shitja e patundshmërive dhe aktivitetet e tij totali 449,000.00 euro dhe tjetra:
Burim Kuçi e dt: 06.12.2013 i cili deklaroi mjetet e pranuar në vlerë prej 145,530.00 euro, këto mjete janë pranuar nga pronari i QMI-së Haziz Tafaj në llogarin e „ Agrokosova Holding “ me nr. [redacted] në TEB bankë

Ekzistojn kontrata mbi brartjen - transferin e të drejtave pronësore në pronën e paluajtëshme lidhur me dt:02.12.2011 në mes të :

1. „ Euro Invest : sh.p.k. të cilin e përfaqëson drejtori Isuf Jemeni .
2. Isni Jemeni si person fizik .
3. „ Agrokosova Holding “ sh.p.k. përfaqësues i autorizuar Haziz Tafaj .
4. Haziz Tafaj si person fizik dhe
5. NPN „ Dili Comerc “ të cilin e përfaqëson Drejtori Fadil Gashi .

Haziz Tafaj me qëllim të përmbushjes të detyrimeve të Agrokosova Holding ndaj ndermarrjes Dili Comerc lidh kontrat mbi kryerjen e punëve ndërtimore të dates 16.06.2011 ndaj me qëllim të përmbushjes të kësaj kontratës me pëlqimin e ndermarrjes Dili Comerc ndaj Euro Invest respektivisht ndaj Isni Jemeni Haziz Tafaj detyrohet të bartë transferoj Isni Jemenit pronën e tij të paluajtëshme - gastren nr.P.-71914050 00930-7 në sipërfaqe prej 7500 m² e cila gjendet në zonen Kadastrale Matiqan - KK- Prishtinë në vendin e quajtur „Arata Tona“ të cilin Haziz Tafaj e ka në pronësi sipas Çertifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtëshme me nr. UL-71914050-03367 të datës 02.12.2011;

Euro Invest detyrohet që me qëllim të përmbushjes së detyrimeve të Isni Jemenit ndaj Dili Comerc për paluajtëshmerin e bartur nga Haziz Tafaj tek Isni Jemeni me pëlqimin e Dili Comerc , detyrohet që ndermarrja Dili Comerc të ia bartë në posedim dhe në pronësi 10 banesa në sipërfaqe të përgjithëshme prej 867,47 m².

Ekzistojn kontrata mbi shitëblerjen e paluajtëshmërisë e lidhur me datë 20.12.2011 në mes të Haziz Tafaj (shitësi) dhe Isni (Sadri) Jemeni (blerësi) .

Haziz Tafaj pronën e tij të paluajtëshme - gastren nr.P.-71914050 00930-7 në sipërfaqe prej 7500 m² e cila gjendet në zonen Kadastrale Matiqan - KK- Prishtinë në vendin e quajtur „ Arat Tona “ dhe gastren kadastrale me nr.P. P.-71914050 00930-196 me sipërfaqe të përgjithëshme 854 m², e cila gjendet në zonen Kadastrale Matiqan - KK- Prishtinë në vendin e quajtur „ Arata Tona “ ia shetë Isni Jemenit në vlerë prej 250,000.00 €.

Vlen të ceket se për disa raste i njëjti është hetuar nga Prokuroria Themelore Prizren e për të cilat raste edhe kemi kuptuar se janë pushuar hetimet .

Gjithashtu në lidhje me keqpërdorimet nga ana e Haziz Tafaj nga Sektori i Hetimeve të korrupsionit DHKEK-DPP -Prishtinë ndaj të njëjtit është ushtruar kallëzim penal ku i njëjti kishte bërë kërkesë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për pagesën e shpronësimit të gastrave Kadastrale të pronave të paluajtëshme të kompanisë „ Agrokosova Holding “ . Me datë 08.08.2012 në emër të kompanisë „ Agrokosova Holding “ në llogarin bankare të TEB bankës janë derdhur mjetet në shumën prej 445,398.38 euro , me date 31.10.2012 në shume prej 148,944.08 euro dhe me date 04.03.2013 në shumë prej 29,029.00 euro të gjitha këto shuma janë derdhur po të njëjten llogari kallëzimi penal për rastin në fjalë është dërguar në P.Th.Prishtinë

Nga Njësia e Hetimeve Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (NJHKEK) - Prizren me date 21.04.2015 është ushtruar kallzim penal ndaj personit Haziz Tafaj për Prokurorin Themelore - Departamenti i Përgjithshëm - Prizren për veprën: Keqpërdorimi i Autorizimve në Ekonomi nga neni 290 paragrafi 1.4,1.5 KPRK .

Nga rastet që u cekën më lart kuptohet se i dyshuari Haziz Tafaj është recidivist i veprave të ndryshme Penale .

Gjithashtu vlen të ceket se një ankesën e palës ankuese janë cekur edhe disa emra të disa personave dhe disa vepra tjera penale por pas analizimit të shkresave të lendes dhe shkresave që kemi arritur të sigurojmë nuk kemi mundur të sigurojmë prova të mjaftueshme për të ngritur kallëzim penal edhe ndaj personave të tjerë dhe për vepra tjera penale.

I mbetet prokurorisë që të analizojë se të dhënat e paraqitura në Kallëzimin Penal a paraqesin bazë të mjaftueshme të fillojë fazën e procedurës penale, nëse vlerëson se ekziston dyshim i bazuar të ngrit aktin akuzues apo nëse vlerëson se është e nevojshme të ndermirret edhe ndonjë veprim shtesë hetimor të na autorizoj me shkrim duke përfshirë edhe analizimin e raporteve të auditorëve të cilët raporte janë shumë kontradiktore .

Kallëzimi Penal së bashku me dëshmitë materiale i dorëzohet Prokurorisë Themelore të Prishtinës.

Këtij raporti do të gjeni të bashkangjitur :

- Dëshmitë e sjellura nga kompania „ Agrokosova Holding” të datës 22.05.2015- 76 fletë.
- Verifikimi në SIPK , - 8 fletë.
- Kërkesa për mbledhjen e Informatave nga Prokuroria Themelore -Prizren , - 1 fletë
- Deklarata e dëshmitarit Sami Ademi, 8- fletë .
- Kërkesa ILECO, - 2 fletë

Faqe 20 nga 22

- Përgjigjeje nga ILECO, 4 fletë
- Kërkesa për MBPZHR -1 fletë.
- Përgjigjeja nga MBPZHR - 131 fletë.
- Kërkesa për ATK-në - 1 fletë
- Përgjigjeje nga ATK-ja - 54 fletë.
- Kërkesa për TEB- bankën - 1 fletë.
- Përgjigjeje nga TEB-banka - 35 fletë.
- Deklarata e dëshmitarit Ymredin Osmani si dhe dëshmit -1,295 flet.
- Kërkesa për Prokurorin Speciale të Kosovës te datës 14.01.2016 - 2 fletë.
- Shënimi Zyrtarë nga Prokuroria Speciale Prishtinë -2 fletë.
- Kërkesa për ARBK-në - 1 fletë.
- Përgjigjeja nga ARBK-ja -823 fletë.
- Kërkesa për AKP-në - 1 fletë.
- Përgjigjeje nga AKP-ja- 278 fletë.
- Kërkesa për mbledhjen e Informatave nga Prokuroria Themelore -Prizren e datës 18.04.2016 ,- 1 fletë.
- Deklarata e dëshmitarit Habib Usaj si dëshmitë e dt. 06.05.2016 ,- 69 fletë.
- Deklarata e dëshmitarit Gianfranco Fantinel si dhe dëshmitë e dt. 11.05.2016 - 77 fletë.
- Kërkesa për Banken Ekonomike -1 fletë.
- Përgjigjeja nga BKT-ja - 37 fletë.
- Kërkesa për AKP-në 25.05.2016 -1 fletë.
- Përgjigjeje nga AKP-ja -2 fletë.
- Kërkesa për Agjensionin Kadastral e Kosovës -1 fletë.
- Përgjigjeje nga AKK-ja e dt.23.05.2016 - 40 fletë.
- Raport Informues për P.TH. Prizren e dt. 24.05.2016 - 2 fletë.
- Kërkesë për P.Th-Prizren e dt. 24.05.2016 -2 fletë .
- Urdhëres për Urdhërkontrollë -2 fletë.
- Deklarata e të Dyshuarit Haziz Tafaj si dhe dëshmitë e dt. 25.05.2016 -21 fletë.
- Raport Informues për Prokurorin Themelore Prizrenë e dt.26.05.2016 - 3 fletë.
- Kërkesë për NJIF-K -2 fletë.
- Përgjigjeje nga NJIF-K e dt. 30.05.2016 - 8 fletë.
- Kërkesë për P.Th-Prizren e dt. 31.05.2016 -2 fletë .
- Urdhëresë për zbulimin e të dhënave financiare -14 fletë
- Raportë Informues për P.TH-Prizren e dt. 24.06.2016 -2 fletë.
- Autorizimin nga P.Th.Prizren e dt. 18.07.2016-2 fletë.
- Kërkesë për Ekspertin Financiar -1 fletë.
- Kërkesë nga P.Th- Prizren e dt.15.11.2016 -1 fletë.
- Raportë Informues për P.Th.Prizrenë e dt. 25.11.2016- 1 fletë.
- Analiza Financiare e dt. 30.11.2016 -43 fletë
- Kërkesë për AKP-në e dt 27.12.2016 -1 fletë.
- Përgjigjeje nga AKP-ja e dt 29.12.2016 - 25 fletë.
- Deklarata e dëshmitarit Agim Kastrati e dt. 24.01.2017 -5 fletë.
- Deklarata e dëshmitares Besa Berisha e dt. 27.01.2017 - 20 fletë
- Deklarata e dëshmitarit Nijazi Junuzi e dt. 27.01.2017 -15 fletë.
- Deklarata e dëshmitarit Limon Morina e dt. 30.01.2017 -3 fletë.